

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Dua ta nis fjalën time me një studim nga Eurostat-i, i cili thotë se në vitin 2020 Shqipëria pati performancën më të keqe në Europë, me rreth 51% të popullsisë në rrezik për varfëri dhe përjashtim social. Mendoj se vetëm ky fakt flet vetë për punën e kësaj qeverie. Sa i përket projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dua të theksoj vetëm një detaj në lidhje me nenin 1 të tij, ku thuhet që shkronja “d” e nenit 14 “Rimbursimi”, shfuqizohet. Do të pyesja hartuesit e këtij projektligji se çfarë është parashikuar për bizneset që prek kjo pikë, të cilën po e perifrazoj: “Për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je dhe sipas masës, kritereve, 4 kushteve e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”. Mirë që e penalizoni këtë kategori, por a i japin hartuesit e këtij projektligji një alternativë tjetër lehtësuese? Për sa i përket projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022” dua të theksoj se qeveria e ka çuar borxhin publik në nivele alarmante. Shtetet e forta, natyrisht, maten edhe me financat që kanë, ndërsa Kryeministri ynë mburret me borxhet që merr, siç ndodhi me borxhet për rimëkëmbjen.

Paragrafi i fundit i nenit 58 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” e përcakton qartë: “Borxhi total publik, përfshirë garancitë, nuk duhet të tejkalojë limitin 60 për qind të produktit të brendshëm bruto”. Ky ligj u ndryshuar për herë të parë nga qeveria e djathtë në vitin 2012, me ligjin nr.114, datë 7.12.2012, që e shfuqizoi këtë paragraf, për të ardhur te qeveria e majtë në vitin 2016, me ligjin nr.57/2016, që i hapi rrugë të lirë rritjes së borxhit publik. Më vjen keq t’ju lodh me shifra dhe nuk do të doja të vazhdoja me diskutime teknike në lidhje me buxhetin e vitit 2021, por dua të sjell në vëmendjen tuaj se, me sa duket, arritjet e qeverisë nuk paskan të sosur! I mëshohet shumë suksesit të reformës në drejtësi, por drejtësinë e keni lënë pa buxhet: Prokurorinë e Përgjithshme nga minus 28% në minus 33% më pak se në vitin 2021; Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në minus 53% më pak se në vitin 2021; Këshillin e Lartë të Prokurorisë deri në minus 83% më pak se në vitin 2021, po ashtu edhe Shkollën e Magjistraturës. I mëshohet shumë pandemisë dhe shëndetësisë falas, por shëndetësinë e keni lënë pa buxhet, në minus 44% më pak fonde dhe investime se në vitin 2021. I mëshohet shumë arsimit dhe rinisë, por arsimin dhe rininë i keni lënë pa buxhet, 5% më pak se në vitin 2021. Gjithashtu, dua të theksoj se dhe në këtë projektbuxhet qeveria ka lënë në harresë ish-të persekutuarit politikisht, të cilët ende presin një përgjigje. Me keqardhje, kjo çështje mbetet në diskutimet parlamentare dhe duhet të pranojmë që është e pafalshme vonesa e kësteve, të cilat shumë prej ish-të përndjekurve nuk arritën t’i merrnin në kohë.

Sot, pas 30 vjetësh demokraci, janë akoma rreth 4000 të zhdukur prej regjimit diktatorial dhe për ta nuk ka qoftë dhe një memorial në shenjë kujtimi. Ndonjëherë duhet të kthejmë kokën nga e kaluara për të ecur para dhe një hap i tillë duhet të nisë nga mbështetja për ish-të përndjekurit politikë. Për

sa i përket relacionit të projektligjit, ku theksohet se projektbuxheti 2022 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist, dua të sjell në vëmendjen tuaj faktin se zëvendëskryeministri Ahmetaj, së bashku me Ministren e Financave Delina Ibrahimaj, shpallën në datën 30 shtator 2021 shifrën bombastike të deklaruar nga INSTAT-i për rritjen ekonomike të tremujorit të dytë 2021, 18% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në gjykimin tim, më duket rënie e madhe nga 18% në 4,1%, që është projektuar për vitin 2022. Ose shifrat e tremujorit të dytë të vitit 2021 nuk janë të sakta, ose diçka e keqe pritet të ndodhë në ekonominë shqiptare gjatë vitit 2022. Sa i përket rritjes ekonomike, që u deklarua në masën 18% për tremujorin e dytë të vitit 2021, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, dua të theksoj disa fakte.

Së pari, duhet të jemi më të ndershëm me shifrat që u serviren qytetarëve, jo se ata nuk i kuptojnë, por është shumë e pandershme nga ana e qeverisë dhe INSTAT-it të fyejë inteligjencën qytetare dhe të luhet pisët me shifrat që publikohen. Kjo rritje, në pjesën më të madhe të saj, përbëhet nga rënia e një viti më parë si rezultat i pandemisë Covid-19, ndërsa pjesa tjetër, që mbetet pjesë e rritjes prej 18 %, përbëhet nga fondet që u dhanë në ekonominë shqiptare për rindërtimin. Nuk dihet saktë nëse këto fonde ishin për rindërtimin apo kishin të bënin me ndonjë korrupsion elektoral. Nga ana tjetër, një pjesë tjetër e rritjes ekonomike vjen nga fakti se shumë shqiptarë i harxhuan pothuajse të gjitha kursimet e tyre për të mbajtur frymën gjallë, duke shpenzuar për ilaçe, pajisje mjekësore dhe shërbimin shëndetësor. Natyrisht që edhe këto para bëhen pjesë e suksesit tuaj ekonomik, të qeverisë dhe rritjes me 18%. Nisur nga një këndvështrim akoma më i zyrtë, edhe të ardhurat që realizuan funeralet në këtë periudhë janë pjesë e kësaj rritjeje ekonomike! E vetmja shifër e besueshme në relacion është ajo e uljes së normës së papunësisë nga 11,4% në vitin 2021, në 10,3% në vitin 2022.

Madje, jam shumë optimiste që kjo shifër do të jetë shumë më e ulët, po t'i referohemi numrit të qytetarëve, sidomos rinisë, që po e braktisin Shqipërinë. Ajo që dhemb më shumë sot është fakti se Shqipërinë nuk po e braktis më vetëm rinia, por po e braktisin edhe akademikët, qytetarët me nivel ekonomik të lartë deri te biznesmenët shumë të fuqishëm. Kjo do të thotë shumë për ekonominë shqiptare dhe ecurinë e kësaj qeverie. Më tej në relacion thuhet se gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, ekonomia shqiptare shfaq shenja mjaft inkurajuese, duke shënuar rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik. E njëjta logjikë si më lart, krahasimi i kësaj periudhe bëhet me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur e gjithë Republika e Shqipërisë ishte e mbyllur me javë të tëra dhe kur qeveria juaj akordoi pagat e luftës. Rregulli bazë kur bëjmë krahasime është: sa më i vogël të jetë emëruesi, aq më i madh rezulton herësi. Prandaj, theksoj edhe një herë faktin që duhet të jemi më të drejtë me shifrat që publikojmë dhe ua servirim qytetarëve si arritje. Në pjesën ku ju flisni për politikën sektoriale dhe përfitimet për qytetarin, në seksionin “Bujqësia dhe zhvillimi rural”, keni përcaktuar prioritete për periudhën 2022-2024 për sektorin e bujqësisë, për periudhën afatmesme, ku ndër të tjera përmendni edhe katër prej tyre: mbështetje për agroindustrinë; mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale; mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët; mbështetje e fermerëve nëpërmjet skemës së re të përjashtimit nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit të karburantit për prodhim bujqësor. Në projektligjin “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, të paraqitur nga ana juaj, nuk më rezulton një mbështetje e tillë për fermerët. Këtë e tregon dhe protesta e tyre në Lushnjë. Kjo është arritja juaj për fermerët; kjo është ajo që u premtoni fermerëve. Ky projektligj më shumë më duket mbështetje për oligarkët e kësaj fushe, duke pasur parasysh nenin 3 të projektligjit, të paraqitur për miratim, sesa ndihmë për fermerin e thjeshtë.

Dua t'i rikujtoj qeverisë se, kur flet për investime, nuk duhet të mbështetet te borxhet, sidomos tek ato të rindërtimit, si në rastin e zonës së Fushë-Krujës, Krujës, Thumanës dhe Bubqit, sepse u desh një

shkundje toke 6,4 ballë që qeveria të kthente sytë drejt kësaj zone. Kjo është një fatkeqësi kombëtare dhe ky është realiteti që na shoqëron çdo ditë. Faleminderit!